


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



PERIUDHA	1M	3M	1V	3V	5V	NGA THEMELIMI
REZULTATI	+0.41%	+3.15%	+7.38%	+16.01%	+31.11%	+41.89%
BENÇMARKU*	+0.10%	+1.09%	+1.59%	+1.29%	+4.20%	+34.24%

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM1 2017

ÇMIMI I AKSIONIT:

JANAR	▲ +0.18%
SHKURT	▲ +2.54%
MARS	▲ +0.41%
GJITHSEJ PERFORMANCA NETO	▲ +3.15%

KTHIMI BRUTO:

JANAR	+€3.05 mln
SHKURT	+€36.95 mln
MARS	+€6.71 mln
GJITHSEJ KTHIMI BRUTO	+€46.71 mln

FAKTET KRYESORE

ÇMIMI I AKSIONIT €1.4189	MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,494,829,613
PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €6.66 mln	PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT €6.66 mln
LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR 1,321	LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT 1,321
LLOGARI TË KONTRIBUESVE 548,621	LLOGARI AKTIVE NË FUND TË PERIUDHËS 238,803
KONTRIBUES TË RINJ KËTË VIT 6,726	KONTRIBUTE TË REJA KËTË VIT €37.65 mln
SHËRBIME TË OFRUARA KËTË VIT 25,661	GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI 69,573

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES PËR TM1 2017

MENAXHUESI/EMETUESI	EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT /BANKËS	PLASMANET	PJESËMARRJA	PERFORMANCA	KONTRIBUIMI NË PERFORMANCËN BRUTO TË FKPK-SË
Vanguard	Global Stock Index Fund - Euro	€378,473,626	25.32%	+5.12%	+1.38%
Nordea	1-Stable Return Fund	€239,732,532	16.04%	+3.22%	+0.51%
Nordea	1-Global Stable Equity Fund	€177,880,980	11.90%	+4.54%	+0.53%
BNY Mellon	Global Real Return Fund	€141,496,074	9.47%	+1.92%	+0.18%
AXA	Global Inflation Linked Bonds	€85,955,900	5.75%	+0.34%	+0.03%
Thesari i Republikës së Kosovës	Obligacione dhe fletobligacione	€78,404,717	5.25%	+0.60%*	+0.02%
AXA	WF Optimal Income I EUR	€ 75,115,828	5.03%	+3.04%	+0.14%
Pictet	High dividend selection Z EUR	€61,358,292	4.10%	+4.39%	+0.18%
Schroders	ISF Global Diversified Growth	€74,085,565	4.96%	+2.25%	+0.08%
Amundi	Rendement Plus Part I2	€51,003,918	3.41%	+1.49%	+0.05%
BNP Parvest	Diversified Dynamic	€51,250,461	3.43%	+2.31%	+0.09%
Schroders	Strategic Bond - Euro Hedged	€10,269,644	0.69%	+0.58%	+0.00%
Banka Kombëtare Tregtare	Depozitë me afat	€8,033,674	0.54%	+0.06%*	+0.01%
Banka për Biznes SH.A.	Depozitë me afat	€8,042,214	0.54%	+0.08%*	+0.01%
TEB SH.A.	Depozitë me afat	€4,011,174	0.27%	+0.03%*	+0.00%
GJITHSEJ MJETE TË INVESTUARA		€1,445,114,599	96.70%	+3.15%	3.20%

*Performanca e bazuar në norma fikse të interesit.

€46.7 MLN KTHIMI BRUTO PËR TM1 2017

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës njohu rezultate pozitive nga investimet edhe në TM1 2017. Kthimi bruto nga investimet për këtë periudhë ishte €47mln dhe çmimi i njësisë u ngrit për 3.15% në €1.4189. Në fund të TM1 mjetet neto që FKPK-ja kishte nën menaxhim iu afruan vlerës së €1.49 mld, ose një rritje prej €76.86 mln nga fundi i tremujorit paraprak. Në rritjen e mjeteve nën menaxhim ndikuan: kthimi nga investimet me €46.71 mln dhe kontributet e reja me €37.65 mln. Ndërkohë për të njëjtën periudhë: për pension u shpagueu €6.66 mln, për tarifa menaxhuese €1.71 mln dhe u refonduan 1,157 euro.

FAKTORËT ME NDIKIM

Sikurse zakonisht, tregu i aksioneve përfiton më së shumti në terrenin e zhvillimeve pozitive ekonomike, ndërkohë që tregu i bonove qeveritare performoi më dobët. Ndikimin kryesor në këtë zhvillim e kishin treguesit shumë të mirë makroekonomikë në SHBA që çuan indekset kryesore drejt rekordeve të reja të ngritjes. Kjo e bazuar në treguesit e një rritjeje të fuqishme të prodhimit industrial dhe ulje të papunësisë në SHBA. Po ashtu plani i Presidentit për uljen e taksave i dha edhe më shumë optimizëm investitorëve. Ndërkohë edhe Europa njohu ngritje, dhe kjo nën dritën e përmirësimit të treguesve të fuqisë blerëse dhe mbajtjes në fuqi të masave stimuluese nga BQE. Inkurajuese ishin edhe të dhënat e përmirësimit ekonomik në Azi dhe vendet në zhvillim, me tregun e aksioneve në Kinë që njohu TM1-shin më të mirë në dhjetë vjetët e fundit. Emërues i përbashkët i ngritjes ekonomike në SHBA e Europë ishte zhvillimi i teknologjisë së informacionit, që priu me rritjen më të lartë edhe këtë tremujor.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Këtë tremujor të gjitha fondet investuese të angazhuara nga FKPK-ja njohën performancë pozitive. Dallimi mes tyre ishte se fondet me përqendrim në aksione reflektuan më mirë gjendjen në tregjet financiare sesa fondet me pjesëmarrje të bonove në portofol. Këtë tremujor fondi i Vanguard, i pastër në aksione, ishte dominues me kthim prej 5.1% dhe njëkohësisht duke ndikuar me 43.1% performancën e përgjithshme të FKPK-së. Më pas ishte fondi i Nordea GSEF, po ashtu në aksione, me performancë prej 4.5% dhe me kontribut prej 16.6% në performancën e përgjithshme të FKPK-së. Në vendin e tretë ishte fondi Nordea SRF, me fond në multi-asete, me një performancë prej 3.2% dhe me kontribut prej 15.9% në performancën e përgjithshme të FKPK-së. Në fakt këto tri fonde së bashku kontribuan në 75.6% të performancës së FKPK-së për këtë tremujor.

Nga fondet e tjera, dobët ishte fondi i AXA GILB i lidhur me nivelin i inflacionit global, me një rritje prej 0.3% dhe ndikim në performancën e përgjithshme me vetëm 0.9%. Jo larg ishte edhe fondi i Schroders SB i tregut të bonove, me performancë prej 0.6% dhe ndikim prej 0.0% në performancën e FKPK-së për shkak të alokimit të ulët që FKPK ka në këtë fond. Detajet e performancës së secilit fond dhe ndikimit në performancën e përgjithshme të FKPK-së janë prezantuar në tabelën e faqes 3.

Nga ana tjetër, investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe kontribuan mesatarisht në performancën e përgjithshme me 0.2%.

PERFORMANCA NETO E INVESTIMEVE NË TM1

+3.15%

BORDI MBAJTI MBLEDHJEN E PARË PËR 2017

Bordi Drejtues, në mbledhjen e 24 marsit 2017, pasi ka shqyrtuar gjendjen e të gjitha investimeve dhe fondeve investuese, dhe bazuar në rekomandimet e Komisionit të Investimeve, ka marrë këto vendime: 1) të ndryshohen limitet në matricën e Manualit të Investimeve; 2) të ndryshohen kufijtë dhe targetet për matricën e Alokimit Strategjik; 3) të tërhiqen €37 mln nga fondi i Vanguard; 4) të investohen €14 mln në fondin e AXA GILB; 5) të investohen €12 mln në fondin e AXA WFOI; 6) të investohen €22 mln në fondin e Schroders GDG; 7) të investohen €22 mln në fondin e BNP Parvest si dhe 8) të konkurrohet në bonot 5-vjeçare të Kosovës me €10 mln.

PUBLIKOHEN PASQYRAT E AUDITUARA FINANCIARE

Gjatë prill janë publikuar në uebfaqen e FKPK-së pasqyrat financiare për vitin 2016. Deloitte është kompania që ka realizuar auditimin e jashtëm dhe në opinionin e saj ka deklaruar se: "Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Fondit më 31 dhjetor 2016, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar me atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)".

SHPËRNDAHEN PASQYRAT VJETORE

Gjatë prillit është përmbyllur shpërndarja e pasqyrave vjetore me Postën e Kosovës, sipas ligjit në fuqi. Për shkak se me ligjin e ri në rastin e dërgimit elektronik të pasqyrave nuk ka nevojë të dërgohen të njëjtat me postë, FKPK-ja ka ulur numrin e pasqyrave të dërguara për rreth 100 mijë dhe në total janë dërguar 278,430 sosh. Sidoqoftë, për shkak se kontribuuesit vazhdojnë të ankohen se nuk e marrin pasqyrën nga Posta, FKPK-ja synon të rrisë edhe më tej numrin e kontribuuesve në eTrusti ose t'i dërgojë pasqyrat me e-mail.

HYN NË FUQI NDRYSHIMI I FUNDIT LIGJOR

Këtë tremujor kanë hyrë në fuqi ndryshimet dhe plotësimet më të fundit ligjore që u bënë me ligjin Nr. 05/L-116. Ky ligj rregullon aspektet rreth mandatit dhe përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit, mënyrën e informimit të kontribuuesve, trajtimin e mjeteve të paalokuara, tërheqjen e kursimeve pensionale dhe trajtimin tatimor të kontributevevullnetare. Ky ligj mund të shkarkohet mund të vizitohet në adresën vijuese: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=13269>

€6.66 MLN PENSIONE NË TM1

Vlera e pensioneve të shpaguara këtë tremujor arriti në total €6.66 mln, ndërkohë që numri i llogarive të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet numëruan 1,321. Shuma e tërheqjeve gjithsesi është më e lartë sesa më TM1 2016 kur ishin shpërndarë €4.82 mln por, njëkohësisht, edhe numri i përfituesve të pensionit ishte më i ulët (1,168).

GATI 70 MIJË LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë hapur llogari në eTrusti deri në fund të TM1 2017 arriti në 69,573 ose një rritje prej rreth 11% për këtë tremujor. Kjo rritje erdhi falë promovimit të këtij shërbimi në rrjetin social Facebook. Shërbimi eTrusti ofrohet falas dhe çdo kontribuues mund të hapë llogari duke vizituar adresën në vijim: <https://online.trusti.org/>

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Maj 2017

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. #182-184
10000 Prishtinë

Shërbimet për klientë: +381-38-600-025
Zyra Qendrore: +381-38-600-020

info@trusti.org
www.trusti.org